

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vera 2026/ Mes premtimeve për siguri dhe 19 viktimave
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/17/vera-2026-mes-premtimeve-per-siguri-dhe-19-viktimave/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:50:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 14:47:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e2b047d794e5a9e5f1b87ca522db6bee39cbe75b379fcb61c05dde6fd657e497
TEKSTI	4fd22799addbd95c81627d19dacc2d56f99e327ae600b03cf48b55f2542da34
PAMJA	c369f8d0c9cc0100de0d3c9ee6cd1a3dea3e4c2d9738131bbd22abe52f410127

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0d199a08de8615752ab1c52293970558cb3dbc4245e99d26d1640e309cbe1e43
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0d199a08de8615752ab1c52293970558cb3dbc4245e99d26d1640e309cbe1e43>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Vera 2026/ Mes premtimeve për siguri dhe 19 viktimave

16:47 : 17/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE



Vera e vitit 2026 mbetet në bilancin e zi të sigurisë publike: 19 viktima, mes të cilëve edhe një turist i huaj. Përplasjet me armë në zona të frekuentuara, dhuna e shfrenuar në lokalet e natës dhe skandali i efektivëve të policisë që punonin privat si roje sigurie, rrëzuan narrativën e shifrave rekord të turizmit.

Ndërsa qeveria premtoi “sezonin më të sigurt që Shqipëria ka parë ndonjëherë”, realiteti në terren dëshmoi se shtimi i uniformave blu nuk ndali hovin e krimit.

Plan me 1635 efektivë dhe zonat “me njollë të zezë”

Për të menaxhuar fluksin, Policia e Shtetit zbriti në terren një Task-Forcë prej 1635 efektivësh policie. Mbrojtja u përqendrua kryesisht në ato që vetë autoritetet i përcaktuan si zona me risk të lartë.

Drejtori i Departamentit për Rendin dhe Sigurinë Publike, Dhimitraq Ziu vizatoi hartën e rrezikut: “Zonat që ne i cilësojmë me njollë të zezë mbeten akset drejt Lezhës, Shëngjinit e Tales, rruga drejt Vlorës, plazhet e Himarës e Sarandës, si dhe akset Durrës-Golem e Lushnjë-Fier.”

Lexo edhe:

[Përgjimet e Ron Yeffet/ Këlliçi: Rama, i përfshirë drejtpërdrejt në trafikun e armëve](#)

[A do ta lëshojë PS nëse SPAK kërkon sërish arrestimin? Berisha: Qeveria sot është Balluku-Rama](#)

Përveç pranisë së shtuar të efektivëve të policisë, Ziu njoftoi gjithashtu ngritjen e stacioneve provizore nga Thethi e Valbona deri në Lalëz e Ksamil, duke mbuluar si bregdetin ashtu edhe turizmin malor.

Premtimet politike arritën kulmin më 26 qershor, kur ministri i Brendshëm Besfort Lamallari deklaroi se siguria do të ishte karta kryesore e imazhit të vendit:

TË GJITHA



Vera 2026/ Mes premtimeve për siguri dhe 19 viktimave

16:47 : 17/09/2026



Po fshihet në Shqipëri? Arratisja e Alket Rizait, policia greke në ndjekje të gjurmëve të tij

16:43 : 17/09/2026



Velipojë/ Pësoi arrest kardiak pasi u fut në det, humb jetën pushuesi nga Kosova

16:22 : 17/09/2026



Daja i deputetes së PS e dhunoi/ 34-vjeçarja sqaron foton e publikuar nga Zegjineja: Si qëndron e vërteta

16:20 : 17/09/2026



Tromp: Specialja u krijua për të kënaqur Serbinë, jo për drejtësi

15:53 : 17/09/2026



Njeriu i familjes së Ramës kontrollon qindra mln euro/ Spahia: OSHIS, 12 tendera me vlerë 105 mln euro në 6 javë

15:44 : 17/09/2026



Përgjimet e Ron Yeffet/ Këlliçi: Rama, i përfshirë drejtpërdrejt në trafikun e armëve

15:41 : 17/09/2026

“Kur një turist zgjedh Shqipërinë, nuk zgjedh thjesht një plazh apo mal, por zgjedh një shtet që e mbrojnë me profesionalizëm. Le ta bëjmë sezonin 2026 më të sigurtin në histori, që çdo vizitor të largohet me kujtime të bukura dhe Shqipëria të vazhdojë të jetë një histori suksesi që frymëzon dhe tërheq botën”.

Statistikat zyrtare tregojnë një ecure dramatike që sfidon çdo retorikë parandaluese:

- Maj-Shtator 2023: 18 raste vrasjeje (19 viktima)
- Maj-Shtator 2024: 17 raste (22 viktima)
- Maj-Shtator 2025: 17 raste (18 viktima)
- Maj-Gusht 2026: 16 raste vrasjeje (18 viktima)

Bilanci u përqendërua në shtator. Më 3 shtator një tjetër vrasje e çoi numrin e viktimave në 19, ndërsa më 13 shtator u regjistrua edhe një tjetër tentativë vrasjeje. Pa përfunduar ende zyrtarisht sezoni, me 19 jetë të humbura, viti 2026 e kaloi bilancin e vitit 2025 dhe barazoi atë të 2023-shit.

Ngjarja që e nxori problemin e sigurisë turistike përtej kufijve ishte vrasja e 20-vjeçarit portugez Luis Miguel Varela Mendes në Ksamil. Në orët e para të mëngjesit të 18 gushtit, Mendes ndodhej në një lokal nate, ku pas një konflikti me disa persona u qëllua me thikë për vdekje. Ngjarja ndodhi në pikën më të nxehtë të sezonit turistik, në një prej destinacioneve më të frekuentuara të vendit dhe pikërisht në një kohë kur siguria ishte shpallur prioritet kombëtar.

Për ekspertin e turizmit Lyto Alliu, ngjarje të tilla ndikojnë në perceptimin e sigurisë dhe në imazhin e Shqipërisë si destinacion turistik: “Rasti tregon efektin që krimi ka mbi vendimin e turistit për t’u kthyer apo për të rekomanduar Shqipërinë”.

Nga ana tjetër, eksperti i sigurisë Fatjon Softa gjen shkakun te mungesa e parandalimit të ngjarjeve: “Duhet të identifikohen paraprakisht zonat me risk, subjektet problematike dhe hapësirat ku alkooli, armët apo konfliktet spontane mund të prodhojnë pasoja të rënda.”

Përtej parandalimit, goditjen më të madhe e merr sistemi i drejtësisë. Eksperti ligjor Alban Duraj rikujton se gjatë vitit 2025 veprat penale u rritën me 17.4% (rreth 38 345 raste). Sipas tij, sistemi i mbingarkuar dhe me vonesa nga procesi i vetëgjyqësorisë e bën arrestimin vetëm hapa të parë në një rrugë të gjatë ndëshkimi: “Drejtësia duhet të provojë fajësinë në një proces të rregullt dhe brenda një kohe të arsyeshme. Sistemi gjyqësor vijon të përballet me pasojat e vetëgjyqësorisë, largimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe dhe ngarkesën e lartë të gjykatave” shprehet Duraj.

Policia në shërbim të privatëve dhe hija e krimit në biznese

Një ngjarje në Sarandë nxori në dritë një tjetër anë të errët: degradimin e autoritetit shtetëror. pasi rojet e sigurisë të një lokali nate dhunuan shefin e krimeve në Sarandë, hetimet zbuluan se dy punonjës policie punonin ilegalisht si roje private në të njëjtin ambient. Ata u pezulluan pasi jo vetëm nuk njoftuan strukturat, por as nuk ndërhyrën për të parandaluar përplasjen.

“Problemi lind kur funksioni publik mbivendoset me interesin privat,” paralajmëron Fatjon Softa, duke bërë thirrje që Policia të ruajë garantimin e rendit dhe jo perceptimin se është e lidhur me interesa biznesi.

Siguria turistike nuk u vu në pikëpyetje vetëm nga vrasjet. Në Orikum, një përplasje mes biznesmenësh shkaktoi panik te pushuesit. Një shqiptare nga Italia tregoi anulimin e pushimeve:

“Na regjistrojnë si turistë në kufi, por kur pamë përplasjen në hotelin ku kishim rezervuar, i anuluan të gjitha. Kemi ardhur për të pushuar, jo për të rrezikuar jetën”.

Kjo pasiguri ushqehet edhe nga financimi i bizneseve bregdetare me para të pista. Lokali ku u vra turisti portugez u vu nën shënjestër si pasuri e mundshme e krijuar nga krimi. Vetëm në 7 muajt e parë të vitit 2026, SPAK ka vendosur sekuestro preventive mbi 440 milionë euro pasuri (kryesisht hotele e prona bregdetare), të dyshuara se janë krijuar me burime financiare të përfituara nga veprimtari të paligjshme, kryesisht nga trafiku ndërkombëtar i lëndëve narkotike.

Retorika politike për ngjarjet

Teksa opozita denoncon keqmenaxhimin e sezonit dhe rendin e dështuar, ku sipas saj vrasjet, atentatet kanë dominuar kronikat e turizmit, ekzekutivi shikon faktorë të tjerë si pengesë. Krveministri Edi Rama gjatë podcast-it të tij “Flasim” deklaroi se rënia e rezervimeve në këtë

sezon që pritej të ishte më i suksesshmi erdhi nga protestat, duke i cilësuar ato si:

“Dëmtim i drejtpërdrejtë për ekonominë lokale dhe kombëtare.”

Megjithatë, pasojat e verës së vitit 2026 lënë pas një pyetje të pashmangshme: Nëse zonat e rrezikut u identifikuan dhe forcat policore u shtuan në terren, pse krimi vazhdoi të diktonte bilancin e verës?/acqj.al

Etiketa: [Edi Rama](#) [qeveria](#) [verë](#)

Lajme të lidhura



Përgjimet e Ron Yeffet/ Këlliçi: Rama, i përfshirë drejtpërdrejt në trafikun e armëve

15:41 : 17/09/2026



A do ta lëshojë PS nëse SPAK kërkon sërish arrestimin? Berisha: Qeveria sot është Balluku-Rama

14:16 : 17/09/2026



Gjykata e Tiranës liron protestuesit e arrestuar pas tubimit të së hënës

13:06 : 17/09/2026



Berisha-socialistëve: Edi Rama është kryepisi, si minj do ju marrë me vete në anijen që po mbytet

12:40 : 17/09/2026



Protestuesit zhvendosen sërish pranë Kuvendit: Qeveri e krimi, ju erdhi fundi!

12:11 : 17/09/2026



Të rinjtë u lënë vendin të moshuarve! Punësimi i pensionistëve dyfishohet në tre vjet

10:40 : 17/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto:

NA NDIQ

